

Syllabusi i lëndës

Lënda: E Drejta Familjare

Programi i studimit: Studime Islame

Numri i ECTS kredive: 6

Statusi i lëndës: e detyrueshme

Kodi i lëndës: 207

Fondi i orëve: 2+2

Viti akademik: 2026-2027

Semestri: i -IV-të

Mësimdhënësi: Ilmije Kuqi

Përmbajtja e shkurtër e lëndës

Kjo lëndë ofron një shpjegim të detajuar të dispozitave të fejesës, përkufizimit të martesës, shtyllave dhe kushteve të saj, kujdestarisë në martesë, grave të ndaluara. Ajo gjithashtu trajton të drejtat dhe detyrat martesore të gruas dhe burrit, si dhe të drejtat dhe detyrat e përbashkëta. Po ashtu, trajton zgjidhjen e kontratës së martesës me shkurorëzim, me marrëveshje në këmbim të meritit, ndarje gjyqësore dhe periudhën e pritjes (idetit).

Qëllimi i lëndës

Qëllimi i lëndës "E drejta familjare" është:

- Mësimi i procedurave ligjore sipas Islamit, të cilat rregullojnë martesën dhe ndarjen e dy individëve.
- Përgatitja e studentëve për të praktikuar mënyrat e lidhjes martesore, rregullat e saj dhe procedurat e divorcit në rastet kur marrëdhënia nuk funksionon më.
- Rritja e ndërgjegjësimit të individëve mbi kërkesat dhe procedurat për martesë dhe divorc.
- Prezantimi i koncepteve të Islamit që lidhen me organizimin e jetës familjare dhe ndërtimin e marrëdhënieve të shëndosha brenda familjes.

Rezultatet e pritura të nxënies:

Në përfundim të këtij kursi studenti i vlerësuar pozitivisht do të jetë në gjendje:

- Të kuptojë se jeta vazhdon me përgjegjësi të ndryshme, të cilat kërkojnë vëmendje dhe angazhim.
- Të kuptojë se Islami e ka lejuar martesën, por e ka rregulluar atë brenda një kornize

ligjore dhe etike të qartë.

- Të kuptojë se Islami ka ofruar përgjigje dhe mundësi për zgjidhjen e problemeve të jetës, përfshirë divorcin, në rastet kur martesë dështon.
- Të kuptojë se jeta familjare në Islam është e detajuar dhe i nënshtrohet analizave të thella, duke ofruar zgjidhje për çdo situatë që mund të krijohet.
- Të kuptojë se duhet të jenë të përgjegjshëm dhe seriozë kur mendojnë të martohen dhe të shmangin situata që mund të çojnë në divorc.
- Të kuptojë se Islami paraqet një sistem të avancuar dhe të balancuar për organizimin e jetës familjare.
- Të mësojë se Islami synon të parandalojë devijimet morale dhe sëmundjet shpirtërore që mund të rrjedhin nga epshi dhe sjelljet e dëmshme.

Metodologjia e mësimdhënies:

Lënda zhvillohet në formë ligjëratash, duke përdorur diskutime interaktive dhe inkurajuar pjesëmarrjen aktive të studentëve. Gjatë ligjëratave, përfshihen analiza të detajuara, ndërkohë që punimet seminarike semestrale janë gjithashtu pjesë e procesit të mësimdhënies.

Raportet ndërmjet studentit dhe profesorit janë të hapura, duke i mundësuar studentëve një mbështetje të vazhdueshme për të arritur rezultate të suksesshme.

Përmbajtja e lëndës:

Nr.	Java	Ligjëratat
1.	Java I	Njoftim i përgjithshëm me lëndën, literaturën, vlerësimin e studentëve, etj, si dhe qëndrimi i Islamit ndaj familjes dhe konceptet bazë të sociologjisë së saj.
2.	Java II	Thirrja e Islamit për martesë, motivet për martesë, si dhe rehabilitimi psikologjik për ata që do të martohen.
3.	Java III	Fejesa, rregullat e islamit për zgjedhjen e qiftit bashkëshortor, si dhe mënyra e zgjedhjes dhe verifikimit të zgjedhjes.
4.	Java IV	Plotësimi i fejesës dhe përfundimi i saj.
5.	Java V	Përkufizimi i martesës, ligjshmëria, urtësia, dispozita, përbërësit e kontratës.
6.	Java VI	Kushtet e kontratës së martesës, regjistrimi i saj dhe llojet e kontratave.
7.	Java VII	Pengesat e martesës: gratë e ndaluara me ndalim të përhershëm dhe ato me ndalim të përkohshëm.
8.	Java VIII	el-Kefaetu, el-vilajeh dhe dëshmia.

9.	Java IX	Përkufizimi i mehrit, ligjshmëria, urtësia, dispozitat e tij.
10.	Java X	Përkufizimi i furnizimit, shkaqet e tij, dispozita, arsyeja e obligimit, kushtet e obligimit, fushat obligative të furnizimit, si dhe shumë dispozita tjera të lidhura me të. Trashëgimia ndërmjet bashkëshortëve.
11.	Java XI	Pjeset përbërëse të divorcit dhe kushtet e tij dhe llojet e divorcit.
12.	Java XII	Ndarja e divorcit sipas kohës së lidhur për të, si dhe ndarja me marrëveshjen e dy bashkëshortëve.
13.	Java XIII	Ndarja nga ana e gjykatësit, rastet për të cilat nuk ka ndarje, gjurmët që renditen mbi ndarjen bashkëshortore.
14.	Java XIV	Përkufizimi i idetit, ligjshmëria, urtësia, dispozitat e tij, si dhe ligjshmëria e rikthimit të bashkëshortes, norma dhe urtësia e tij.
15.	Java XV	Pjesët përbërëse dhe kushtet e rikthimit dhe disa dispozita të tjera lidhur me të.

Provimi përfundimtar

Kriteriumi dhe komponentët e vlerësimit:

Pjesëmarrje dhe angazhimi në ligjëratë 10%

Punimi seminarik 10%

Testi intermedier 40%

Provimi final 40%

Total 100%

Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes:

Studenti duhet të respektojë institucionin dhe rregullat e përcaktuara, duke përfshirë:

- Respektimin e orarit të ligjëratave.
- Mbajtjen e disiplinës dhe të qetësisë gjatë ligjëratave.
- Pasimin e udhëzimeve të mësimeve.
- Ndalimin e përdorimit të celularëve apo pajisjeve të tjera gjatë orëve të mësimit.

Literatura obliguese:

E Drejta Familjare në Islam, grup autorësh, Shkup, 2004.

Fik'hu Hanefi, Abdulhamid Mahmud Tuhmaz, Zurch, 2011.

Bedai es-Senai, Ebu Bekr bin Mesud el-Kasani, Kairo, 2005.

Kontributi në ngarkesën e studentit

Aktiviteti	Orë	Ditë\Javë	Gjithsej
Ligjërata	3	15	45
Ushtrime teorike	2	15	30
Punë praktike	-	-	-
Kontaktime me mësimdhënësin\konsultimet	1	10	10
Ushtrime në terren	-	-	-
Kollokfiume, seminare, ese	1	10	10
Detyra të shtëpisë	1	20	20
Koha e studimit vetanak të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi)	1	30	30
Përgatitja përfundimtare për provim.	5	4	20
Koha e kaluar në vlerësim (teste, ese, provim final)	2	5	10
Totali	16	15 javë	175